

## FJALA E DEPUTETES DHURATA ÇUPI

E ENJTE 27 JANAR 2022

Të nderuar deputetë!

Sot është sjellë në seancë për miratim projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për noterinë””, sepse këtë gjë e kërkon Moneyval-i dhe FATF-ja. Javën e shkuar në komisionet parlamentare janë diskutuar disa projektligje me këtë arsye dhe justifikim, si një refren përsëritës dhe jo i besueshëm, jo vetëm për ne që kemi qenë në ato komisione, por edhe për ata që na dëgjojnë. Prej shkurtit të vitit 2020, Shqipëria është përfshirë në listën e vendeve nën monitorim të shtuar (lista gri) nga grupi i posaçëm i veprimit financiar FATF, organ ndërqeveritar, që përcakton në nivel ndërkombëtar standardet dhe që nxit zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave. Pra, strukturat monitoruese ndërkombëtare e kanë futur Shqipërinë në listën gri, në listën e vendeve me risk të shtuar të pastrimit të parave të pista, kurse qeveria kërkon t’u hedh hi syve këtyre agjencive dhe qytetarëve shqiptarë me arsyetimin se këto ndryshime do ta nxjerrin vendin tonë nga listat regressive për sa u takon standardevë europiane mbi pastrimin e parave.

Kjo qeveri, që e ka futur vendin me vetëdije dhe koshiencë të plotë në listën e vendeve të pastrimit të parave, nuk mund të bëjë në të njëjtën kohë sikur po bën përpjekje për ta nxjerrë nga këto lista, sepse nuk duhet bërë sikur, por duhen bërë veprime të besueshme dhe të dukshme, që të bindin se këto përpjekje janë serioze dhe bindëse. E vërteta është krejt tjetër. Ju keni paraqitur projektligjin “Për noterinë” me pretekstin që po reflektoni sugjerimet e Moneyval-it, por ndërkohë qëllimi i vërtetë duket qartë: do të bëni ndryshime për të kapur politikisht edhe noterët. Asnjë risi dhe reformë për të dalë nga lista gri. Projektligji sjell në dispozitat e tij koncepte si “integriteti” dhe “besueshmëria profesionale” apo “kontakte të papërshtatshme”, të cilat lidhen drejtpërdrejt me qëllimin që ka ministri i Drejtësisë për të kryer vetingun e noterëve. Ky akt parashikon kriteret dhe procedurat e verifikimit të integritetit moral dhe profesional të noterëve apo kandidatëve për noterë. Sipas këtij projektligji, i gjithë ky proces do të drejtohet nga ministri i Drejtësisë. Është paradoksale të mendosh se si verifikimi mbi veprimtarinë e noterëve dhe certifikimi i tyre mbi vazhdimësinë në profesion do të drejtohet nga ministri i Drejtësisë, i cili nuk e ka kaluar as vetë këtë proces. Një autoritet i pacertifikuar me të njëjtat procedura dhe që nuk ka kaluar në po të njëjtin proces, nuk ka kredo morale dhe politike për të propozuar dhe drejtuar një proces vetimi për profesionet e lira, në këtë rast noterët. Morali i reformës në drejtësi ishte i thjeshtë: njerëzit që japin drejtësi duhet të jenë në rregull me ligjin dhe të aftë profesionalisht.

Vetëm në këtë mënyrë mund të rritet besimi i qytetarëve te gjyqësori dhe Shqipëria të përvijojë një perspektivë të qartë europiane, duke plotësuar standardet europiane për sa i përket besimit se institucionet garantojnë sundimin e ligjit. Në 8 vjetët e qeverisjes së Partisë Socialiste kemi parë përpjekje të vazhdueshme, që nëpërmjet ndryshimeve ligjore, të maskuara pas qëllimeve në dukje të mira, të uzurpohen kompetenca dhe pushtete që, në fakt, duhet të ushtrorjnë funksionet e tyre pa pasur vazhdimisht ankthin e ndërhyrjes së qeverisë. Kjo u pa veçanërisht në reformën në drejtësi, ku nëpërmjet një sërë makinacionesh, përfshirë vetingun, qeveria socialiste ia doli të largojë nga sistemi shumë prokurorë dhe gjyqtarë që konsideroheshin si kundërshtarë, duke futur në sistem apo duke vendosur në pozicione kyçe njerëz me marrëdhënie familjare dhe miqësore të ngushta me vetë qeveritarët. Projektligji “Për noterët” dhe kompetencat që i jep politikës për të rrëmuar në jetën e të

tjerëve, pa pasur moralin dhe besueshmërinë për ta nisur si një proces, duhet të krijojë njëkohësisht edhe hapësirën publike dhe politike të nevojshme për ta rikthyer vetingun e politikanëve në vëmendjen e qytetarëve dhe ligjvënësit. Prandaj, Partia Demokratike ka propozuar vetingun e politikanëve, një paketë ligjore, e cila do të bëjë të mundur kalimin në sitë të pasurisë dhe veprimtarisë së politikanëve. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të përfitojmë një autoritet politik legjitim me kredon e mjaftueshme për të vetuar të tjerët. Konkretisht, projektligji parashikon një dispozitë të posaçme, e cila i jep të drejtë ministrit të Drejtësisë të bëjë verifikimin e integriteti të të gjithë noterëve. Pra, projektligji përmban disa parashikime, që jo vetëm krijojnë paqartësi, por edhe ngrenë hije dyshimi mbi qëllimet ambicioze që paraqet propozuesi.

Konkretisht, projektligji ka sanksionuar përkufizimet “integriteti” dhe “besueshmëria profesionale”, duke e lidhur me mungesën e kontakteve të papërshtatshme dhe sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin noterial. Pikërisht lidhur me këto dy përkufizime lind edhe shqetësimi i adresuar në komentet e Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe të OPDAT-it, që ende nuk kanë marrë asnjë përgjigje, as në komision nuk morën përgjigje.

Projektligji nuk përmban asnjë përkufizim se çfarë do të konsiderohet sjellje e rëndë e papërshtatshme etike dhe morale, që cenon besimin e publikut në sistemin noterial. Një shprehje e tillë mund të lërë vend për interpretime të gjera dhe abuzime. Në këtë kuptim vlerësoj se ky projektligj është vazhdim i përpjekjes së kësaj qeverie për uzurpimin e një tjetër pjese të rëndësishme të sistemit të drejtësisë nëpërmjet vetingut të dyfishtë të noterëve nga një organ tërësisht politik. Këtë herë pa u përpjekur aspak të fshihen pas komisioneve politike, synohet kontrolli i plotë i hyrjeve në këtë profesion. Nga ana tjetër, për noterët që janë aktualisht në profesion projektligji ka parashikuar mekanizma që i vendos ata nën kontroll politik në raste të caktuara. Këta mekanizma do të përdoren për të nxjerrë nga sistemi njerëz që pushteti i konsideron të padëshiruar, duke i zëvendësuar me besnikët e partisë. Qytetarët nuk kanë nevojë për një trupë legjislative që nxjerr mijëra akte juridike në vit, pa pasur më të voglin impenjim në përafrimin e interesave të tyre me interesat e qytetarëve. Besimi i qytetarëve në sistemin politik është po aq i rëndësishëm sa besimi te drejtësia. Vetingu i politikanëve synon të krijojë kushtet për një klasë politike legjitime të besueshme. Ndarja nga një periudhë e errët 30-vjeçare në raport me pasuritë që politika ka vënë në kurrizin e qytetarëve mund të fillojë vetëm nëpërmjet një rregullimi ligjor, kushtetues dhe proporcional, si i vetmi instrument i ligjshëm për të ndarë të mirën nga e keqja, të drejtën nga paligjshmëria dhe politikanin në shërbim të interesit publik nga ai në dobi të interesave të tij meskine. Nëse deri më sot reforma në drejtësi është marrë me strukturat e gjyqësorit, pritej që shërbime parajyqësore, si avokatia, noteria dhe ndërmjetësimi të rregulloheshin në shërbim të së mirës publike dhe sa më pranë qytetarit. Qytetarëve u duhet një shërbim sa më korrekt dhe cilësor në aktet noteriale dhe kthimi i besimit në këto akte. Qytetarët sot kanë një shërbim të pamërituar për sa i takon cilësisë së shërbimeve noteriale dhe këtu duhet të ishte e nevojshme ndërhyrja apo iniciativa ligjore. Duket qartësisht që këto nuk do të ndodhin, por thjesht kapja dhe akaparimi edhe i këtyre shërbimeve. Ligji “Për noterinë” është miratuar 2 vjet më parë dhe në vitin 2021 ka filluar implementimin, duke krijuar strukturat e para që përcaktonte ligji, kurse sot vijnë ndryshime që ministri i linjës të kontrollojë gjithçka. Për pyetjen sa noterë janë ndëshkuar gjatë këtyre viteve, nuk u dhanë as numra, as emra, as gjoba, as masa ndëshkimore dhe as informacione për aktet noteriale që kanë sjellë pastrim parash, edhe pse të gjithë e dimë që nëpërmjet akteve noteriale janë cenuar rëndë procedurat ligjore.

Nëse ne sot besojmë se me këto ndryshime, që ju keni sjellë, do të ndalohet pastrimi i parave, do të jetë e gabuar, prandaj ne, deputetët e opozitës, nuk do të bëhemi pjesë e kësaj farse dhe do të votojmë kundër këtij projektligji. Në fund dua të flas pak edhe për shqetësimin e qytetarëve të lagjes “5 Maji” në Tiranë. Ne, deputetët e opozitës në Komisionin e Ligjeve, kemi kërkuar një dëgjese publike me

kryetarin e bashkisë së Tiranës, drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, Avokatin e Popullit dhe me një përfaqësi banorësh. Kam qenë personalisht në një takim me ata banorë, të cilët i kam informuar se nesër në orën 14:00 në Kuvend do të zhvillohet një dëgjese publike për të gjitha shkeljet që janë bërë nga institucionet shtetërore kundër atyre banorëve dhe lagjes "5 Maji". Faleminderit!